



ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

SEKRETARIA

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më __.04.2020

NJOFTIM

**Për mbledhjen Nr. 18, datë 04.05.2020, ora 14:00
të Bordit të ERE-s.**

Në zbatim të (i) nenit 13 të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; të ndryshuar, (ii) Rregullores bazë së Organizimit dhe Funkcionimit të Entit Rregullator të Energjisë të miratuar me Vendimin e ERE-s Nr. 144/2019 dhe (iii) nenit 11 të “Rregullores për Organizimin, Funkcionimin dhe Procedurat e ERE-s” miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr.96, datë 16.07.2016, (iv) Aktit Normativ të Këshillit të Ministrave Nr. 8, datë 24.03.2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në aktin normativ nr. 3, datë 15.03.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për marrjen e masave të vecanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID – 19”, të ndryshuar, si dhe VKM Nr.243, datë 24.03.2020 “Për shpalljen e fatkeqësisë natyrore”, njoftojmë se **ditën e Hënë, datë 04.05.2020, ora 14:00** do të zhvillohet mbledhja nr. 18 e Bordit të ERE-s sipas këtij rendi dite:

1-Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë “Alpiq Energy Albania” sh.p.k, nr. 291, seria FK15, në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të komisionerëve të ERE-s, nr. 73, datë 13.05.2015

2-Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë “Alpiq Energy Albania” sh.p.k, nr. 290, seria T15, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të komisionerëve të ERE-s, nr. 72, datë 13.05.2015

3-Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “PowerComm” sh.p.k, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike

4-Mbi shtyrjen e afatit të kryerjes së monitorimeve pranë shoqërive të licencuara në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centralet eolike

Në zbatim të pikës 1 të Urdhërit të kryetarit të ERE-s nr. 53, datë 11.03.2020, “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-2019” dhe Urdhërit nr. 53/1, datë 24.03.2020 “Për një ndryshim në urdhërin nr. 53, datë 11.03.2020”, “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore”, mbledhja nuk do të jetë e hapur për publikun.

KRYETARI I ERE
Petrit AHMETI